



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 84/2012
Prishtinë, më 20.11.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N–225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha–Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Fikrim Damka dhe Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të ftuar: Besnik Berisha dhe Fatmir Gërvalla – ART; Blerim Koci, Ejup Hasolli dhe Krenar Bujupi – ZRRE; Ibush Jonuzi, Selvete Grajçevci - Pllana dhe Haradin Gërvalla - KPMM; Halit Gara dhe Enis Berisha - ARH; Avni Jashari dhe Naim Avdiu - AKP; Ahmet Krasniqi, Halit Shabani dhe Abdyl Krasniqi – AKK; Dritan Gjonbalaj- AAC.

Pjesëmarrës të tjerë: Mimoza Gojani - Ambasada Britanike; Dita Dobranja dhe Darsej Canhasi – INDEP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;
3. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2013;

Kryetari – Tha se Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në cilësinë e Komisionit Funkcional, për këtë pikë të rendit të ditës, ka paraparë të diskutojë Projektligjin për Buxhetin e Republikës, me theks të veçantë, buxhetin dhe projektet buxhetore që kanë të bëjnë me Agjencitë dhe Rregullatorët që i raportojnë Komisionit, siç janë: Autoriteti i Aviacionit Civil - AAC; Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit - ART; Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave - ARH; Autoriteti i Konkurrencës të Kosovës - AKK; Zyra e Rregullatorit të Energjisë - ZRRE; Agjencia Kosovare e Privatizimit - AKP dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM. Më pas kryetari ua dha fjalën sipas radhës të gjithë përfaqësuesve të agjencive, për të paraqitur kërkesat e tyre që kanë të bëjnë me Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2013.

Ibush Jonuzi- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) – Falënderoj Komisionin për mundësinë e dhënë dhe paraqiti kërkesën si vijon: 1. për staf shtesë në departamente profesionale; 2. për staf profesional inspektor të xehetarisë në terren dhe 3. për blerjen e pajisjeve për konfiskim.

Avni Jashari -Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) – Tha se jemi të kënaqur gjerësisht me buxhetin e ndarë, mirëpo, kërkoj mbështetje që ti aprovohet kërkesa prej tre (3) milion euro që e kanë bërë për riorganizimin e Kombinatit Trepçës, sepse u janë ndarë vetëm një (1) milion.

Ahmet Krasniqi -Autoriteti i Konkurrencës të Kosovës (AKK) – Tha se kemi problem me akomodim dhe ky problem po përsëritet vit pas viti. Si rrjedhojë, po kemi pastaj problem edhe me mosshfrytëzimin e buxhetit që e kemi të ndarë për rekrutimin e stafi, sepse s’kemi ku t’i vendosim, pasi që kemi vetëm tri zyra. Ai tha se vitin e kaluar e kemi pas të miratuar një shumë prej 50 mijë euro, por sivjet nuk e kemi. Kërkoj që t’u aprovohet kërkesa për rrezikshmëri për AKK-në.

Halit Gara - Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) – Tha se kemi mungesë të stafit, si të atij profesional, ashtu edhe atij administrativ dhe kjo është evidentuar edhe ne Raportin e Progresit të Komisionit Evropian dhe kërkoj që të aprovohet kërkesa për staf të nevojshëm profesional.

Blerim Koci - Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) – Tha se jemi të kënaqur me buxhet, mirëpo, përsëri na duhet staf shtesë dhe së shpejti do të gjejmë një lokacion tjetër, nga ky që e kemi momentalisht.

Dritan Gjonbalaj - Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) – Tha se jemi të kënaqur me ndarjen e buxhetit edhe pse në fillim ka qenë një kalkulim i gabuar, mirëpo, pas seancave dëgjimore në Ministri të Financave, kjo është evituar.

Besnik Berisha - Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) – Tha se na duhet mbështetje për të përfutur kërkesën për rrezikshmëri për paga dhe mëditje, sepse inxhinierët dhe stafi i janë ekspozuar punës së ndjeshme edhe në terren.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

- 1. Në mbledhjen e radhës të përgatiten Rekomandimet në bazë të kërkesave për secilën Agjenci apo Rregullator;*
- 2. Pas harmonizimit të Rekomandimeve, ato t'i dërgohen Komisionit të përhershëm për buxhet dhe financa;*
- 3. Të kërkohet nga Agjencitë dhe Rregullatorët t'i dorëzojnë më shkrim Komisionit raportin e tyre nëntë (9) muaj të shpenzimeve; listën e pagave dhe mëditjeve për bordet dhe stafin; listën e vizitave dhe trajnimeve që kanë ndjekur.*

3. Të ndryshme

Kryetari – I njoftoi deputetët se ka angazhuar ekspertin z.Sahit Abazi për shqyrtimin e projektligjit për zonat ekonomike, i cili do t'i ofrojë Komisionit asistencën profesionale nga kjo fushë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit